

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mos ia vrisni Hashim Thaçit Kosovën që fitoi me luftë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/editorial/mos-ia-vrisni-hashim-thacit-kosoven-qe-fitoi-me-lufte-i586544
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:48:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6c057b71fefeb97e4e1587557dd1cbb85a1bd6386881b0a751c50f4a4b1ecac4
TEKSTI	c0d42e9310ec3f5274c1f58f42ea0a77507b622ae9c579f7516eac2dadd130b6
PAMJA	f114528a65e9d6aa59cfe45979e394d915ac1681f1f4e75ff2271d268b043e9c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3d84e5542800d1e2a93b41223a68c309d485f53d8ddf449f0e9262ada0369be7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3d84e5542800d1e2a93b41223a68c309d485f53d8ddf449f0e9262ada0369be7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Mos ia vrisni Hashim Thaçit Kosovën që fitoi me luftëPlagoset me arme zjarri avokati në Durres, policia në kërkim të autorit, zbardhen emratSulmi me dron - Ukraina p fundit

Mos ia vrisni Hashim Thaçit Kosovën që fitoi me luftë



16 Shtator 2026, 19:46Editorial Mero Baze

Vendimi i sotëm i Hagës ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit është i rëndë dhe tronditës për Kosovën. Bota shqiptare e përjeton atë si një goditje pas shpine nga një gjykatë e kontrolluar nga Perëndimi ndaj atyre që ajo i ka vendosur në pedestalin e historisë së saj si çlirimtarë të Kosovës.

Dhe zemërimi është i natyrshëm. Edhe teprimi, banaliteti dhe ndoshta thirrjet e dhunshme janë të shpjgueshme.

Një shoqëri e përgatitur për një fitore në Gjykatën e Hagës tani po reagon e çoroditur dhe si e pashpresë përballë këtij vendimi.

Çfarëdo që të ndodhë sot e tutje për ta, edhe në u dënofshin me 81 vjet, edhe në u lirofshin nga Apeli dhe të kthehen në shtëpitë e tyre në Kosovë, ajo që ata kanë bërë për Kosovën dhe për veten e tyre nuk përsëritet më dhe askush nuk mund t'i zbresë nga ai pedestal.

Ndaj çdo reagim ekstrem, që dëmton sot shtetin e Kosovës me arsyetimin se po mbron historinë e heronjve të saj, u bën më shumë dëm heronjve të Kosovës, i bën më shumë dëm Hashim Thaçit dhe shokëve të vet.

Ata që pranuan të dilnin në mal dhe të vdisnin për Kosovën, e bënë që të kishin një shtet të Kosovës dhe ia arritën. Ndaj tani çdo përpjekje për të dëmtuar shtetin në emër të lirisë së tyre jo vetëm i fyen dhe i dëmton ata, por ua hedh në erë veprën më të madhe të jetës së tyre, që nuk është liria e tyre personale, por liria e Kosovës.

Ky është një dëm që u bëhet Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Ata mund të ishin vrarë të katërt në luftë, pasi për t'u vrarë dolën në mal. Fati i bëri ata udhëheqës të luftës dhe të shtetit të ri të Kosovës.

Kjo betejë nuk fitohet duke sulmuar Perëndimin, duke djegur flamuj apo duke e paraqitur Kosovën si viktimë të një komploti të të gjithë aleatëve të saj. Ajo fitohet duke e zbërthyer aktgjykimin, duke kundërshtuar provat, mënyrën si është ndërtuar përgjegjësia individuale dhe, mbi të gjitha, duke ngritur çështjen e dukshme të proporcionalitetit të dënimeve.

Gjykata e Hagës bëri një gjest historik duke mos pranuar akuzat për krime kundër njerëzimit. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme historike dhe politike për Kosovën, pasi ruan rëndësinë e luftës së UÇK-së, drejtësinë e saj dhe të drejtën e popullit shqiptar të Kosovës për liri. Prokuroria nuk arriti të provonte se kishte ekzistuar një sulm i përhapur ose sistematik kundër popullsisë civile si të tillë. Sipas arsytimit të shpallur nga Gjykata, viktimat ishin përzgjedhur kryesisht si individë të konsideruar kundërshtarë apo bashkëpunëtorë të forcave serbe.

Kosova duhet ta ndjekë këtë betejë me të gjithë seriozitetin e një shteti dhe jo ta kthejë në një çështje kuslëshash dhe idiotësish të ministrave të saj të Drejtësisë, që sillen me gjyqin e Hagës si me votat për një kuvend komunal, duke degraduar seriozitetin e shtetit. Madje edhe Shqipëria mund të ndajë legalisht një fond prej miliona eurosh në dispozicion të sqarimit dhe hetimit të këtyre akuzave në Apel, për të mos e lënë fatin e luftëtarëve të lirisë në orekset politike të Prishtinës dhe llogaritë e tyre politike.

E rëndësishme është të shmangim çdo reagim që mund ta izolojë Kosovën, të cilën boll e kanë izoluar këta që e qeverisin. Është e tepërt t'i shtohet edhe një rreth tjetër këtij izolimi nga Gjykata e Hagës.

Kush e shndërron zemërimin ndaj një vendimi gjyqësor në urrejtje kundër Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian apo NATO-s, nuk po i ndihmon katër heronjtë e saj të dënuar nga Gjykata.

Sot Kosova duhet të jetë e bashkuar, por jo e verbuar nga zemërimi. Duke mbrojtur katër udhëheqësit e saj, Kosova duhet të mbrojë pikërisht veprën e tyre më të madhe: aleancën me Perëndimin.

Hashim I naçi ne toke dhe NATO-ja ne qiell e çliruan nje here Kosoven, kurse Hashim I naçi ne Hage dhe guret mbi ambasadat perendimore mund ta varrosin atë.

Beteja për lirinë e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit nuk fitohet duke e lënë Kosovën pa miq. Ajo është një fitore e Pirros, të cilën të parët që do ta neverisnin do të ishin ata të katërt në qelitë e Hagës. Ajo Kosovë nuk i duhet askujt, përveç atyre që e kanë pasur para vitit 1990 dhe që shqiptarët, në fillim me Ibrahim Rugovën dhe më pas me UÇK-në dhe NATO-n, ua hoqën nga duart.

Hashim Thaçi e ka më të lehtë të vdesë në burgun e Hagës sesa të dalë nga burgu dhe ta gjejë Kosovën në një burg të ri, të armiqësuar me ata që e çliruan. Mos ia vrisni ëndrrën që e fitoi me luftë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

E vetmja gjë që nuk ka ndryshuar është përndjekja politike ndaj Erion Veliajt

16:56 Editorial / 58 komente

Drejtësia kërkon drejtësi... për rrogën e vet!

17:55 Editorial / 44 komente

Rasti kur "rojtarë" i drejtësisë kapet në gjumë

18:49 Editorial , 51 komente

Protesta duhet të shqetësohet më shumë nga ardhja e diasporës sesa nga pengimi i saj

16:33 Editorial / 33 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.